# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-450460**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Presidenti i Federatës Gjermane "i shpall luftë" Infantinos: Është e rëndësishme që sistemi i tij të marrë fund |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sport/presidenti-i-federates-gjermane-i-shpall-lufte-infantinos-shte-e-rendesish-i586567` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 19:46:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 20:20:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `525478671bd9deb0b491c7fee2188dc1c6958bb842cc1a56f7f3be64863aa15e` |
| TEKSTI | `06179ed52b3489e6f89953c5be4b587b7b22f3aaadfcc62c32084423cde88ac3` |
| PAMJA | `e55d7bbb74c3b9b931312112fddce88898376c0e6ab7a90144f2507e5471aba3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `24ad6eb5f5ff8136b297f417b096702dcbc1985557fdd52850e78c44726f7068` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/24ad6eb5f5ff8136b297f417b096702dcbc1985557fdd52850e78c44726f7068`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# Presidenti i Federatës Gjermane “i shpall luftë” Infantinos: Është e rëndësishme që sistemi i tij të marrë fund

TemA
16 Shtator 2026, 22:20Sport TEMA



Presidenti i Federatës Gjermane të Futbollit, Bernd Neuendorf, është distancuar nga kreu i FIFA-s, Gianni Infantino, më qartë se kurrë më parë dhe dëshiron të rrëzojë “sistemin” e tij, u shpreh ai për mediat gjermane.

“Është e rëndësishme që edhe ky sistem i Infantinos të marrë fund,” tha Neuendorf për RTL/ntv, duke theksuar se kjo është madje “absolutisht e domosdoshme”.

Neuendorf mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s dhe të Këshillit të FIFA-s në Selanik të Greqisë dhe vazhdoi të theksonte skepticizmin e Gjermanisë ndaj një mandati të ri presidencial të Infantinos.

“Marrëdhënia e besimit me Gianni Infantinon, me këtë udhëheqje të FIFA-s, është sigurisht e shkatërruar”.

Presidenti i FIFA-s po kërkon një mandat tjetër, pavarësisht dështimit spektakolar të planit të tij për investitorët e Kupës së Botës dhe kritikave të ashpra nga pjesë të botës së futbollit, ndërsa zgjedhjet janë caktuar për në muajin mars.

Ndër të tjera, UEFA, e udhëhequr nga presidenti Aleksander Ceferin, po kërkon dorëheqjen e Infantinos dhe po përgatitet të ngrejë një kallëzim penal kundër tij në Zvicër. Synimi kryesor i palës evropiane është ta detyrojë Infantinon të tërhiqet para rizgjedhjes së tij të planifikuar.

Dhjetë federata evropiane të futbollit tashmë e kanë tërhequr zyrtarisht mbështetjen e tyre për të; së fundmi, këtë e kanë bërë Franca dhe Austria. Federata Gjermane e Futbollit (DFB) ende nuk e ka bërë një gjë të tillë, por Neuendorf e ka bërë tashmë shumë të qartë qëndrimin e tij dhe konfirmoi në korrik se federata nuk do ta nënshkruante letrën e mbështetjes të ofruar nga FIFA.

---

## Lini një Përgjigje

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

5 gola në 4 javë, Shpendi "tërbon" Italinë, por emri i del edhe në Angli

17:20 Sport / 2 komente

Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

10:15 Sport / 9 komente

Nga një ‘like’ në Instagram te propaganda serbe, si u shemb skandali i ‘kushteve të këqija’ në Tiranë

21:20 Sport / 3 komente

Ndeshjet e Ligës së Kombeve, zbardhet axhenda e Kombëtares




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.